



A. Musa Tolaj, Nartel Center, Llam. A, H-1,  
Kati 12, nr. 65-1, Prishtinë, Kosovë.  
T. +383 38 600 633, +383 38 600 644  
E. office@kcsfoundation.org  
W. www.kcsfoundation.org

## Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit

Titulli i programit:	KCSF
Titulli i kontratës:	Shërbime të rekrutimit të stafit për nevoja KCSF

### RRETH KCSF-së

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritimit në Bashkimin Europian.

### FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMIT

KCSF synon të angazhojë shërbimet e një kompanie profesionale rekrutimi për të ndihmuar në rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit të kualifikuar për nevoja të organizatës.

Ky dokument përshkruan Termat e Referencës (TeR) për ofrimin e shërbimeve të rekrutimit.

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e drejtpërdrejtë të drejtorit për Administratë dhe Financa, ofruesi/kontraktori i shërbimit pritet që të:

- Identifikojë dhe propozojë staf të kualifikuar dhe të përshtatshëm për pozicione specifike pune brenda KCSF-së.

Kompania e rekrutimit do të marrë përsipër detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Kryen analizë të tregut të punës, duke përfshirë përshkrimet e detyrave të punës, kualifikimet, aftësitë dhe kriteret e përvojës, sipas kërkesave nga KCSF;

- Përzgjedhë kandidatët në listën e ngushtë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga KCSF;

- Dorëzon te KCSF një listë të ngushtë të kandidatëve më të kualifikuar, duke përfshirë CV-të e tyre;

- Lehtëson komunikimin dhe koordinimin ndërmjet KCSF-së dhe kandidatëve gjatë gjithë procesit të rekrutimit;

- Ruan konfidencialitetin dhe siguron mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm në lidhje me procesin e rekrutimit;

## **AFATI KOHOR**

Angazhimi i kompanisë/ve pritet të jetë për afat-më të gjatë, nëpërmjet Kontratës kornizë, për periudhën fillestare nga 12 korriku 2023 deri më 31 dhjetor 2024.

Procesi i parë i rekrutimit në kuadër të kontratës kornizë pritet të fillojë më 12 korrik dhe duhet të përfundojë brenda afatit prej 15 ditësh. Megjithatë, ky afat kohor është subjekt i rregullimit bazuar në kërkesat e KCSF-së dhe disponueshmërisë së kandidatëve të përshtatshëm.

Proceset tjera të rekrutimit për të cilat KCSF do të vendosë që të shfrytëzohë shërbimet e kërkuara me këto ToR do të zhvillohen sipas nevojës, dhe do të komunikohen me kompaninë/të e kontraktuar/a rast për rast.

## **KONFIDENCIALITETI**

Kompania e rekrutimit duhet të sigurojë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të gjitha informacioneve personale dhe të ndjeshme të marra gjatë procesit të rekrutimit. Ata duhet të respektojnë të gjitha ligjet e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

## **VENDI I PUNËS**

Puna duhet të kryhet në Kosovë.

## **KËRKESAT PËR KUALIFIKIM**

Një komision i përzgjedhur nga KCSF do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kompanisë.

Kompania duhet të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme për shërbimin e kërkuar dhe së paku 3 vite përvojë pune në rekrutim të stafit.

## **PROPOZIMI FINANCIAR**

Çmimi në propozimin financiar duhet të kuotohet në euro. Çmimet duhet të kuotohen pa përfshirë TVSH-në dhe shërbimet duhet të ofrohen me çmime fikse të njësisë.

## **DËSHMITË DHE KAPACITETI PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TEKNIKE DHE PROFESIONALE**

Kompanitë e interesuara duhet të demonstrojnë përvojë dhe ekspertizë në fushën e rekrutimit të stafit.

## **VLERËSIMI DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES**

Ofertat do të vlerësohen duke marr parasysh kriteret e mëposhtme të vlerësimit (100 pikë):

1. Oferta financiare (çmimi më i ulët) – 40 pikë
2. Puna e paraqitur përmes portfolios/CV-së së kompanisë, duke dëshmuar përvojën në realizimin e shërbimeve të ngjashme – 60 pikë

## **TERMET DHE KUSHTET**

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në dosje të tenderit ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen.

KCSF rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë.

KCSF rezervon të drejtën për të negociuar me një ose disa ofertues të listës së ngushtë, pas vlerësimit fillestar të ofertave të dorëzuara.

Asnjë ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë ofertuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF.

KCSF rezervon të drejtën për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë.

Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë ose të kërkojë takim për të ndihmuar procesin e vlerësimit.

KCSF rezervon të drejtën për të vlerësuar performancën dhe efektivitetin e kompanisë rekrutuese gjatë gjithë angazhimit. Ky vlerësim mund të përfshijë komente mbi cilësinë e kandidatëve të paraqitur, efikasitetin e procesit të rekrutimit dhe respektimin e afatit kohor të rënë dakord.

## **APLIKIMI**

Të gjitha aplikacionet të dërgohen në adresën elektronike [tender@kcsfoundation.org](mailto:tender@kcsfoundation.org), më së largu më 9 korrik 2023, ora 23:59.